



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 1017/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Hasan Softolli, kandidatë për anëtarë të kuvendit komunalë në Podujevë, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër Komisionit Qëndror Zgjedhor (KQZ), për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Hasan Softolli kandidatë për anëtarë të kuvendit komunalë në Podujevë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Hasan Softolli kandidatë për anëtarë të kuvendit komunal nga LDK-ja në Podujevë, në të cilën pretendon se i mungojnë votat dhe kërkon t'i shohë votat e tij nëpër secilin vendvotim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse PZAP-i nuk është institucion i cili i publikon rezultatet apo të iu informoi se sa vota i posedoni siç keni pretenduar në ankesë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 1017/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24( njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.